



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e zhvillimit të arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

LËNDËT E LIRA ZGJEDHORE NË ARSIMIN FILLOR

AUTORËT

Violeta Petroska-Beshka

Nikolina Kenig

Ajshe Ajrullai

СЛОБОДНИ ИЗБОРНИ ПРЕДМЕТИ ВО ОСНОВНО ОБРАЗОВАНИЕ LËNDËT E LIRA ZGJEDHORE NË ARSIMIN FILLOR

Botues:

Byroja e Zhvillimit të Arsimit

Redaktor:

Abdulfeta Fetaj

Autorë:

Violeta Petroska-Beshka

Nikolina Kenig

Ajshe Ajrullai

Realizimi i hulumtimit në shkolla:

Mr. Afrodita Davko, Aleksandar Jolevski, dr. Zhaneta Çonteva, Vesna Popova, Mare Bojçeska-Saveska, Flora Besimi, Abdiraman Memeti, Ajshe Selmani, Antoaneta Shmit-Tanevska, Bashkim Mislimi, mr. Beti Denkov, dr. Bllaga Paneva, Borjana Janakieva-Zaeva, Vançe Manevski, Vesna Naumoff, Vesna Torbovska-Vasillevska, mr. Valbona Kamberi, mr. Viktor Baxhukov, Vjollca Mehmeti-Nuredini, Vlladimir Partinov, dr. Gabriella Durçevska-Georgieva, Goran Stojanov, Gordana Janakievska, Daniella Taçevska-Nikollov, Gjylaj Isaki-Useini, Emillija Jovanova, Emillija Panovska, Zhaklina Markovska, Zoran Maznovski, mr. Zoran Trajkovski, Irena Borisovska, Irina Gjurovska-Pejoska, mr. Ilir Memedi, mr. Janko Bilbiloski, Jasmina Bogdanovska, Jasminka Nestorovska-Ivanoska, mr. Julija Gligorova-Trajanoska, mr. Keti Dimkovska, Latife Bajrami, Lidija Ginoska, dr. Lidija Kondinska, dr. Marina Dimitrieva-Gjorgjievaska, mr. Mirjançe Milloshevska, Masar Avdiu, Merzije Gashi-Sulejmani, dr. Natalija Acevska, Nafije Sadikoska-Ellezoska, Nevena Boshkovska, mr. Oliver Stanojoski, Ollgica Numoska, Olivera Todoroska, Onur Abdi, mr. Sanja Nikollovska-Paçemska, mr. Sllavko Vellevski, Sanja Dimitrijeviq, Subi Ajro, mr. Tanja Lazarova-Osogovska, mr. Trajçe Kalevski, Albion Trenova, Besir Jonuz, Musa Shasivari dhe Sejhan Kadriovska.

Përkthyes:

Edmond Metaj

Lektor:

Adnan Ajdari

Viti i botimit dhe shtypit – 2024

Vendi i botimit: Shkup

Botimi elektronik

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје 373.3.016(497.7) (047.31)

PETROSKA-Beshka, Violeta

Lëndët e lira zgjedhore në arsimin fillor [Електронски извор] / autorët Violeta Petroska-Beshka, Nikolina Kenig, Ajshe Ajrullai ; [përkthyes Edmond Metaj]. - Shkup :

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, 2024

Начин на пристапување (URL):

<https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2024/04/MINISTERSTVO-ZA-OBRAZOVANIE-I-NAUKA-LIBRI-SHQIP.pdf>.

- Превод на делото: Слободни изборни предмети во основно образование. - Текст во ПДФ формат, 51 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 14.05.2024

ISBN 978-608-206-132-0

1. Kenig, Nikolina [автор] 2. Ajrullai, Ajshe [автор]

а) Слободни изборни предмети – Основно образование – Македонија –Истражувања

COBISS.MK-ID 63664133



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e zhvillimit të arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

LËNDËT E LIRA ZGJEDHORE NË ARSIMIN FILLOR

AUTORËT

Violeta Petroska-Beshka

Nikolina Kenig

Ajshe Ajrullai

Realizimi i hulumtimit në shkolla:

mr. Afrodita Davko, Aleksandar Jolevski, dr. Zhaneta Çonteva, Vesna Popova, Mare Bojçeska-Saveska, Flora Besimi, Abdiraman Memeti, Ajshe Selmani, Antoaneta Shmit-Tanevska, Bashkim Mislimi, mr. Beti Denkov, dr. Bllaga Paneva, Borjana Janakieva-Zaeva, Vançe Manevski, Vesna Naumoff, Vesna Torbovska-Vasillevska, mr. Valbona Kamberi, mr. Viktor Baxhukov, Vjollca Mehmeti-Nuredini, Vlladimir Partinov, dr. Gabriella Durçevska-Georgieva, Goran Stojanov, Gordana Janakievska, Daniella Taçevska-Nikollov, Gjylaj Isaki-Useini, Emillija Jovanova, Emillija Panovska, Zhaklina Markovska, Zoran Maznovski, mr. Zoran Trajkovski, Irena Borisovska, Irina Gjurovska-Pejoska, mr. Ilir Memedi, mr. Janko Bilbiloski, Jasmina Bogdanovska, Jasminka Nestorovska-Ivanoska, mr. Julija Gligorova-Trajanoska, mr. Keti Dimkovska, Latife Bajrami, Lidija Ginoska, dr. Lidija Kondinska, dr. Marina Dimitrieva-Gjorgjievaska, mr. Mirjançe Milloshevaska, Masar Avdiu, Merzije Gashi-Sulejmani, dr. Natalija Acevska, Nafije Sadikoska-Ellezoska, Nevena Boshkovska, mr. Oliver Stanojoski, Ollgica Numoska, Olivera Todoroska, Onur Abdi, mr. Sanja Nikollovska-Paçemska, mr. Sllavko Velleviski, Sanja Dimitrijeviq, Subi Ajro, mr. Tanja Lazarova-Osogovska, mr. Trajçe Kalevski, Albion Trenova, Besir Jonuz, Musa Shasivari dhe Sejhan Kadriovska.

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Qëllimet e hulumtimit	6
Pjesëmarrësit e hulumtimit	7
Instrumentete matëse	11
Rezultatet	12
• Rezultatet për MËSIMDHËNËSIT REALIZUES të lëndëve të lira zgjedhore.....	13
• Rezultatet për MËSIMDHËNËSIT E MUNDSHËM REALIZUES të lëndëve të lira zgjedhore.....	25
• Rezultatet për NXËNËSIT të cilët nuk kishin lëndë të lira zgjedhore.....	33
KONKLUZAT	48
REKOMANDIMET.....	50

HYRJE

Zbatimi i lëndëve të lira zgjedhore në arsimin fillor është njëra nga ndryshimet më domethënëse në përputhje me Konceptin për Arsimin Fillor nga viti 2021. Qëllimi i lëndëve të lira zgjedhore është të sigurohet zhvillimi i mundshëm të secili nxënës, të motivohen nxënësit për të mësuar dhe të kontribuohet në drejtimin e mëvetësimin të nxënësve në arsimimin e mëtejshëm.

Me Konceptin për Arsimin Fillor parashikohet që nxënësit nga periudha e dytë dhe e tretë e arsimit fillor (klasat IV – VI dhe VII – IX) të zgjedhin nga katër kategoritë e lëndëve të lira zgjedhore: 1) për të zgjeruar/thelluar njohuritë nga lëndët e detyrueshme (shembull: analiza dhe shkrimi i poezisë, rezonimi matematiko-logjik, mbrojtja e mjedisit, kultura klasike, gratë gjatë historisë, programimi, piktura/vizatimi/skulpturimi, këndimi solo, vallet popullore); 2) për mbështetjen e interesave të nxënësve të cilët nuk janë pjesë e lëndëve mësimore (shembull: fotografi, kopshtari/hortikulturë, punëtori teatrore, gatim, gdhendje, origami, modelim); 3) për mbështetjen e zhvillimit individual dhe social të nxënësve (shembull: arsimimi për shkathtësitë jetësore, arsimimi për barazinë gjinore, punëtori multikulturore, njohuri financiare) dhe 4) të karakterit sportive-rekreative (shembull: futboll, basketboll, hendboll, volejball, pingpong, joga, pilates, kërcim modern etj.).

Nga secili nxënës kërkohet të zgjedhë dy lëndë të lira zgjedhore gjatë një viti shkollor (një për gjysmëvjetorin e parë dhe një për të dytin), lëndët që ai zgjedh për vitin shkollor që vijon duhet të përkasin

kategorive të ndryshme. Në realizimin e aktiviteteve të lëndës së caktuar zgjedhore marrin pjesë nxënësit me interes të përbashkët, pavarësisht nëse mësojnë në të njëjtën klasë (p.sh. IVa), në paralele të ndryshme të vitit të njëjtë (p.sh. klasa VI) ose në vite të ndryshme brenda periudhës së njëjtës arsimore (p.sh. klasa VII – IX).

Duke pasur parasysh dinamikën e futjes së reformës, në vitin aktual shkollor me Konceptin e ri janë përfshirë vetëm nxënësit e periudhës së parë dhe të dytë të arsimit fillor, që do të thotë se deri më tani vetëm nxënësit e periudhës së dytë (klasa IV - VI) kishin mundësi për lëndë të lira zgjedhore. Për nxënësit e periudhës së parë (klasa I - III), lëndët e lira zgjedhore realizohen në formën e aktiviteteve të lira dhe ndjekin rregulla më ndryshe gjatë organizimit dhe realizimit.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Hulumtimi është realizuar për të siguruar përgjigje në pyetjet e mëposhtme:

1. Për mësime të mësimdhënësve që realizojnë ose kanë realizuar lëndët e lira zgjedhore:

Të shihen përvojat e mësime të mësimdhënësve nga realizimi i lëndëve të lira zgjedhore që të identifikohen nevojat, sfidat dhe përfitimet në lidhje me realizimin e tyre.

2. Për mësime të mësimdhënësve që ende nuk kanë realizuar lëndët e lira zgjedhore:

Të shihen pikëpamjet e mësime të mësimdhënësve në lidhje me rëndësinë e lëndëve të lira zgjedhore dhe gatishmërinë e tyre për realizimin e lëndëve të lira zgjedhore.

3. Për nxënësit e klasave VIII dhe IX:

Të shihen pikëpamjet e perceptimet të nxënësve në lidhje me kuptimin e lëndëve të lira zgjedhore dhe përfitimi nga realizimi i tyre.

PJESËMARRËSIT E HULUMTIM

Në hulumtim janë përfshirë 119 shkolla fillore nga 56 komuna, që paraqet 34,7% të numrit të përgjithshëm të shkollave fillore në territorin e shtetit. Tabela I, në të cilën është treguar struktura nga mostra e shkollave në të cilat është bërë hulumtimi, tregon se ka tre herë më shumë shkolla njëgjuhëshe (73,9%) se shkollat me dy ose tre gjuhë mësimore (26,1%) dhe se përfaqësimi i shkollave nëpër qytete (57.1%) është më i lartë se përfaqësimi i atyre që ndodhen në fshatra (42.9%).

Tabela I: Struktura nga mostra e shkollave sipas përfaqësimit të gjuhëve mësimore dhe vendndodhja e tyre

	Njëgjuhëshe	Shumëgjuhëshe	Gjithsej
Në qytet	51	17	68
Në fshat	37	14	51
Gjithsej	88	31	119

Me hulumtimin janë përfshirë 4,783 mësimdhënës nga shkollat fillore të përfshira, në të cilat realizohet mësimi në periudhën e dytë dhe të tretë të arsimit fillor (nga klasa IV deri në IX). Mësimdhënësit klasor të cilët në vitin vijues shkollor (2023/24) punojnë me nxënës nga periudha e parë (klasa I - III) nuk kanë qenë të përfshirë sepse në këtë periudhë lëndët e lira zgjedhore realizohen në formën e aktiviteteve të lira zgjedhore, sipas rregullave më ndryshe të organizimit dhe realizimit të orëve mësimore. Struktura nga mostra e mësimdhënësve është paraqitur më hollësisht në tabelat II dhe III.

Tabela II: Struktura nga mostra e mësimdhënësve sipas gjinisë dhe llojit të mësimdhënies

	Mësimdhënës klasor	Mësimdhënës lëndor	Gjithsej	%
Meshkuj	198	1 140	1 338	28,0
Femra	1 194	2 251	3 445	72,0
Gjithsej	1 392	3 391	4 783	
%	29,1	70,9		

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën II, shihet se shumica e dukshme e mësimitdhënësve që kanë marrë pjesë në hulumtim janë femra (72%), gjë që është mjaft e pritshme duke pasur parasysh disproporcionalitetin e përfaqësimit gjinor në profesionin e mësimitdhënësit në arsimin fillor. Tabela tregon se dominojnë mësimitdhënësit lëndor (70.9%), gjë që është e arsyeshme, nëse merret parasysh se pjesa më e madhe e mësimitdhënësve klasor (që kanë për detyrë mësimitdhënien nga klasa I deri në III) nuk mund të realizojnë lëndët e lira zgjedhore (të cilët janë qëllimi i këtij hulumtimi).

Tabela III: Struktura nga mostra e mësimitdhënësve sipas gjuhës mësimore dhe vendndodhja e shkollës

	Maqedonisht (maq.)	Shqip (shq.)	Turqisht (tur.)	Gjithsej	%
Qytet	1 721	755	42	2 518	52,6
Fshat	925	964	17	1 906	39,8
Qytet dhe fshat	314	45	0	359	7,5
Gjithsej	2 960	1 764	59	4 783	
%	61,9	36,9	1,2		

Во табелите и во графиконите што следат, скратениците маќ., алб. и тур. се користат за означување на наставниот јазик.

Tabela III tregon se më të përfaqësuar janë mësimitdhënësit që japin mësim në gjuhën maqedonase dhe më pak të përfaqësuar janë ata që punojnë në gjuhën mësimore turke. Të dhënat nga e njëjta tabelë tregojnë se përqindja e mësimitdhënësve që punojnë në shkollat e vendosura në qytet është më e lartë se përqindja e atyre që punojnë në shkollat e vendosura në fshat, ndërsa përqindje shumë e vogël është që japin mësim në shkollë qendrore të vendosur në qytet dhe në shkollën periferike që ndodhet në fshat. Vështrimi shtesë i të dhënave tregon se te mësimitdhënësit që japin mësim në gjuhën maqedonase dominojnë ata që punojnë në shkollat urbane, ndërsa te mësimitdhënësit që japin mësim në gjuhën shqipe më shumë janë të përfaqësuar ata që punojnë në shkollat rurale.

Për nevojat e hulumtimit, mësimitdhënësit nga mostra ndahen në dy grupe në bazë të asaj nëse kanë përvojë në realizimin e lëndës së lirë zgjedhore apo jo: **mësimitdhënësit realizues** (të cilët realizojnë dhe/ose më parë kanë realizuar të paktën një lëndë të lirë zgjedhore.) **dhe mësimitdhënësit të mundshëm realizues** (të cilët nuk kanë realizuar, por mund të realizojnë nëse lind nevoja). Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën IV, grupi i mësimitdhënësve realizues numëron Gjithsej 2097 mësues, që përbën 43,8% të numrit të përgjithshëm të mësimitdhënësve që morën pjesë në hulumtim dhe grupi i mësimitdhënësit të mundshëm realizues përbëhet nga Gjithsej 2686 mësues të mbetur (56.2%). Në kuadër të hulumtimit, dy grupet e mësimitdhënësve janë trajtuar në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Tabela IV: Ndarja e mësimeve sipas përgjigjes së pyetjes: A realizoni tani apo paraprakisht keni realizuar lëndë të lirë zgjedhore sipas Konceptit të ri?

	Maq.	Shq.	Tur.	Gjithsej	
PO: mësimeve realizues	1 128	932	37	2 097	43,8
JO: mësimeve të mundshëm realizues	1 832	832	22	2 686	56,2
Gjithsej	2 960	1 764	59	4 783	
% e zbatuesve në kuadër të gjuhës mësimore	38,1	52,8	62,7	43,8	

Kohëzgjatja mesatare e përvijës së punës të mësimeve është $M = 14,55$ ($SD = 10,16$). Krahasimi i dy grupeve të mësimeve tregon dallime domethënëse në kohëzgjatjen e përvijës së punës ($t = 2,78$; $p < 0,01$, ku përvija mesatare e punës së mësimeve realizues është $M = 15,02$ ($SD = 10,61$), ndërsa i mësimeve të mundshëm realizues $M = 14,20$ ($SD = 9,80$).

Në hulumtim ishin të përfshirë **4909 nxënës** nga dy klasat e fundit të arsimit fillor. Mostra e nxënësve përfshinte nga një paralele të klasës VIII dhe një paralele të klasës së IX-të nga secila gjuhë mësimore e përfaqësuar në shkollat fillore të përfshira në mostër. Struktura e mostrës së nxënësve është paraqitur më hollësisht në tabelat V dhe VI.

Tabela V: Struktura e mostrës së nxënësve sipas gjinisë dhe klasës

	Klasa VIII	Klasa IX	Gjithsej	%
Meshkuj	1 251	1 112	2 363	48,1
Femra	1 256	1 290	2 546	51,9
Gjithsej	2 507	2 402	4 909	
%	51,1	48,9		

Të dhënat e paraqitura në tabelën V tregojnë se në mostrën janë përfaqësuar kryesisht nga vajzat e klasës së IX. Djemtë e së njëjtës moshë janë më pak të përfaqësuar. Megjithatë, dallimet në përfaqësim nga njëra gjini në tjetrën dhe nga njëra klasë në tjetrën nuk janë aq të mëdha sa të pamundësojnë që mostra të konsiderohet i balancuar për sa i përket gjinisë së nxënësve dhe klasës në të cilën ata mësojnë.

Tabela VI: Struktura e mostrës së nxënësve sipas gjuhës mësimore dhe vetëndodhjes së shkollës

	Maq.	Shq.	Tur.	Gjithsej	%
Qytet	2 218	858	192	3 268	66,6
Fshat	798	804	39	1 641	33,4
Gjithsej	3 016	1 662	231	4 909	
%	61,4	33,9	4,7		

Nga tabela VI, vërehet se më të përfaqësuar mostër janë nxënësit që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe se ata që mësojnë në gjuhën turke janë shumë pak të përfaqësuar. Të dhënat nga e njëjta tabelë gjithashtu tregojnë se përqindja e nxënësve që mësojnë në shkollat e qytetit është më e lartë se përqindja e atyre që mësojnë shkollat e fshatit. Vështrimi plotësues i të dhënave tregon se në mesin e nxënësve nga paralelet me mësim në gjuhën maqedonase janë pothuajse dy herë më të përfaqësuar ato që mësojnë në shkollat urbane, ndërsa në mesin e nxënësve nga paralelet me mësim në gjuhën shqipe, pothuajse nuk ka dallim në përfaqësimin e atyre që mësojnë në shkollat urbane dhe ato rurale.

Për të ofruar një pasqyrë më të thellë të përvojave të nxënësve dhe nevojave, perceptimeve dhe preferencave të tyre në lidhje me lëndët e lira zgjedhore, u zhvilluan edhe diskutime në fokus grupe. Në fokus grupe morën pjesë gjithsej 93 nxënës që mësojnë në gjuhën maqedonase (78,5%) në gjuhën shqipe (22,5%), nga nëntë shkolla fillore të vendosura në pesë qytete të ndryshme (katër janë nga Shkupi, dhe njëra është rurale). Struktura e mostrës së nxënësve të përfshirë në fokus grupe, sipas gjinisë dhe klasës, është paraqitur në tabelën VII.

Tabela VII: Struktura e mostrës së nxënësve në fokus grupet sipas gjinisë dhe klasës

	Klasa VIII	Klasa IX	Gjithsej	%
Meshkuj	10	31	41	44,1
Femra	7	45	52	55,9
Gjithsej	17	76	93	
%	18,3	81,7		

Në hulumtimin qëllimisht nuk ishin të përfshirë nxënësit që kanë marrë pjesë ose po marrin pjesë në lëndët e lira zgjedhore, sepse hulumtimi nuk ka synuar të vlerësojë realizimin dhe efektet e këtij mësimi, por përfitimin e perceptuar prej tij nga nxënësit që mësojnë sipas programit të vjetër dhe kanë përvojë me lloj tjetër të lëndëve zgjedhore.

INSTRUMENTET MATËSE

Për të siguruar të dhëna në lidhje me objektivat e parapara të hulumtimit, u krijuan tre pyetësorë – një për nxënësit dhe dy për mësimdhënësit.

Pyetësori i dedikuar për nxënësit përmban 9 pyetje kryesore, të gjitha të tipit të mbyllur (me zgjedhje të përgjigjeve nga më shumë alternativa të ofruara). Në varësi të numrit të alternativave të ofruara, nxënësit patën mundësinë të zgjidhnin dy ose tre përgjigje. Përveç kësaj, nxënësit iu përgjigjën edhe tre pyetjeve demografike - për vendndodhjen e shkollës, për klasën dhe për gjininë.

Për mësimdhënësit u përgatitën dy pyetësorë të ndryshëm: njëri për ata që kanë realizuara lëndët e lira zgjedhore (**pyetësor për mësimdhënësit realizues**) dhe tjetri për ata që deri në momentin e plotësimit të pyetësorit nuk e kishin pasur ende përvojë të tillë. (**pyetësor për mësimdhënësit e mundshëm realizues**). Pyetësori për mësimdhënësit realizues përmban 13 pyetje kryesore kushtuar përvojave gjatë realizimit të lëndëve të lira zgjedhore, si dhe opinioneve përkatëse për këtë lloj mësimdhënie. Mësimdhënësit e mundshëm realizues iu përgjigjën 9 pyetjeve, nga të cilat tre të fundit (ato që u referohen qëllimeve të perceptuara kryesore të kategorive të ndryshme të lëndëve të lira zgjedhore) janë drejtpërdrejt të krahasueshme me pyetjet për nxënësit. Nga të dhënat demografike u kërkuan informata vetëm për gjininë, statusin (mësues klasor ose lëndor), vendndodhjen e shkollës/shkollave (qytet, fshat ose të kombinuara) ku ata punojnë dhe kohëzgjatjen e përvojës së punës.

Për të gjithë pyetësorët u përgatitën tre versione gjuhësore – në maqedonisht, shqip dhe turqisht. Të gjitha u vendosën në Gugl forms (Google forms) si versione të veçanta për nxënësit, pra për mësimdhënësit e gjuhëve përkatëse mësimore. Pyetësorëve iu përgjigjën në mënyrë elektronike, me celular ose në kompjuterët e shkollës. Nxënësit u përgjigjën gjatë orës mësimore.

Të gjithë pjesëmarrësit ishin të obliguar t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve në pyetësorin "e tyre". Për të kaluar në pyetjen tjetër, ata duhej t'i përgjigjeshin pyetjes së mëparshme. Kështu që, të gjitha pyetjet, pa përjashtim, kanë marrë përgjigje nga ana e pjesëmarrësve të mostrës përkatëse.

Të gjithë pjesëmarrësve iu garantua anonimiteti kur iu përgjigjën pyetësorëve. E gjithë procedura e pyetjeve dhe përgjigjeve zgjati rreth njëzet minuta. Procesi i mbledhjes së të dhënave u zhvillua në periudhën nga 1 deri më 10 nëntor 2023.

Fokus grupet janë realizuar gjatë muajit dhjetor, pas vëzhgimit të gjetjeve kuantitative. Në rolin e moderatorëve ishin të angazhuara studentë të psikologjisë paraprakisht të trajnuar dhe një këshilltare nga BZHA. Të gjitha janë realizuar në shkollat ku mësojnë nxënësit e përzgjedhur. Nxënësve iu parashtruan dy pyetje kryesore, me disa nën pyetje në lidhje me preferencat dhe mendimet e tyre për lëndët e lira zgjedhore.

Të gjithë pjesëmarrësve iu garantua anonimiteti. Diskutimet me lejen e pjesëmarrësve u incizuan.

REZULTATET


Para fillimit të prezantimit të gjetjeve nga përpunimi i të dhënave të marra nga dy kategoritë e përfshira të mësimdhënësve (realizues dhe realizues të mundshëm) dhe nxënësve, duhet të merret parasysh, më sa vijon:

1. Theksi i analizës është në përshkrimin e gjetjeve, së bashku me ofrimin e mbikëqyrjeve më të detajuara për dallimet në përgjigjet e marra në gjuhët e ndryshme mësimore dhe kategori të ndryshme të lëndëve të lira zgjedhore.
2. Në të gjithë grafikët dhe tabelat e tekstit në përqindje jepen përgjigjet e pjesëmarrësve. Përjashtim është grafiku 5, në të cilin janë treguar mesataret aritmetike.
3. Pyetjet që ofrojnë mundësinë për të bërë më shumë se një zgjedhje analizohen nga perspektiva e numrit të pjesëmarrësve që iu përgjigjën pyetjes, pra numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve në mostrën përkatës (duke pasur parasysh se të gjithë u detyruan t'u përgjigjen gjitha pyetjeve). Prandaj, përqindjet kumulative për këto pyetje kalojnë 100%.
4. Nisur nga objektivat e studimit, është bërë krahasimi i drejtpërdrejtë i përqindjeve. Numri i madh i pjesëmarrësve të përfshirë e arsyeton këtë vendim kur bëhet fjalë jo vetëm për krahasimet ndërmjet përqindjeve të marra për mostrat totale të kategorisë përkatëse të pjesëmarrësve (nxënës, mësues realizues dhe mësues të mundshëm realizues) por edhe për krahasimet ndërmjet përqindjeve të marra për nëngrupet e pjesëmarrësve me mësim në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe në kuadër të kategorive pjesëmarrëse. Duke pasur parasysh numrin shumë më të vogël, nxënësit dhe mësimdhënësit e përfshirë që mësojnë/punojnë me mësim në gjuhën turke duhet të trajtohen më shumë si ilustrues, ndërsa krahasimet e bëra me këta pjesëmarrës duhet të merren me shumë kujdes.
5. Të dhënat cilësore (nga fokus grupet) analizohen vetëm në nivel përshkrues dhe paraqiten si plotësim i gjetjeve relevante kuantitative në funksion për të thelluar kuptimin e tyre. Citimet e përdorura për të ilustruar gjetjet e analizës cilësore janë paraqitur në formën e tyre burimore e të folurit.

1. REZULTATET E MËSIMDHËNËSVE REALIZUES TË AKTIVITETEVE TË LIRA ZGJEDHORE

Sipas rezultateve të marra, nga 2097 mësues të cilët janë përgjigjur se realizojnë lëndë të lira zgjedhore, rreth 20% e tyre janë angazhuar në më shumë se një lëndë e lirë zgjedhore. Edhe pse mund të argumentohet se ka lëndë të lira zgjedhore që nuk është e lehtë të kategorizohen në mënyrë të qartë në njërin nga kategoritë e ofruara nga pyetësi (1. për zgjerimin, pra thellimin e njohurive nga lëndët e detyrueshme mësimore; 2. për mbështetjen e interesave të nxënësve që nuk janë pjesë e lëndëve të detyrueshme 3. për mbështetjen e zhvillimit personal dhe social të nxënësve 4. me karakter sportiv-rekreativ), nga të dhënat e marra nga mësimitdhënësit realizues, është e qartë se gjatë periudhës kur është bërë hulumtimi, dominojnë ata që kanë funksionin të ndihmojnë në pasurimin e njohurive dhe shkathtësive nga disa lëndë të detyrueshme.


Më shumë se gjysma e mësimitdhënësve (56%) deklaruan se lënda e tyre zgjedhore mund të klasifikohet në këtë kategori. Rreth një e treta e zgjedhjeve të bëra i përkasin kategorisë së lëndëve për të mbështetur zhvillimin personal dhe social të nxënësve (31,1%), ndërsa dukshëm më pak realizohen lëndët e lira zgjedhore të karakterit sportiv-rekreativ (16,3%) ka dhe të tillë që nuk janë në lidhje të drejtpërdrejtë me përmbajtjet e lëndëve të detyrueshme (16,6 %). Grafiku 1, krahas këtyre përqindjeve, paraqitet dallimi i realizimit në katër kategoritë e lëndëve të lira zgjedhore sipas gjuhës mësimore. Kjo tregon se ka dallime të mëdha sa i përket numrit të lëndëve që janë realizuar në mbështetje të interesave të nxënësve që nuk janë pjesë e arsimit të detyrueshëm. Të dhënat tregojnë se ka dallime të mëdha mes pjesëmarrësve me mësim në gjuhën shqipe (3,3%) dhe me mësim në gjuhën maqedonase (27,4%). Dallim tjetër i dukshëm është në përfaqësimin më të shpeshtë të lëndëve nga kategoria e parë ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe (63,4%), krahasuar me ato në gjuhën maqedonase (50,8%). Megjithatë, përjashtimi më i dukshëm nga radhët e shpeshtësisë së realizimit sipas kategorive është me mësim në gjuhën turke. Sipas përgjigjeve të mësimitdhënësve, më së shumti kanë realizuar mësim nga lëndët e lira zgjedhore që ndihmojnë në zhvillimin personal dhe social të nxënësve (59,5%), dhe pothuajse njëloj nga lëndët e karakterit sportiv-rekreativ (29,7%) dhe të tillë që mbështesin lëndët e detyrueshme mësimore (27 %).



Grafiku 1: Përgjigjet e pyetjes nga mësimdhënësit realizues: Në cilën kategori bën pjesë lënda e lirë zgjedhore që keni realizuar/e realizoni?

Kur kategoritë e realizuara të lëndëve të lira do të kryqëzohen me kohëzgjatjen e përvojës së punës së mësimdhënësve realizues, fitohet e dhëna se ata me përvojë më të shkurtër i kanë realizuar lëndët zgjedhore nga kategoria e parë ($M = 15,87$) dhe kategoria e dytë ($M = 15,86$), ndërsa ata me përvojë më të gjatë, lëndët zgjedhore nga kategoria e tretë ($M = 13,30$) dhe nga kategoria e katërt ($M = 13,17$).

Pothuajse gjysma e mësimdhënësve realizues (45%) lëndën e tyre zgjedhore e kanë përgatitur në bashkëpunim me mësues të tjerë nga e njëjta shkollë. Kjo veçanërisht vlen për mësimdhënësit që realizojnë mësim në gjuhën shqipe (52,6%). Rreth një e katërta e mësimdhënësve i kanë përdorë programet e BZHA-së për realizimin e lëndëve të tyre të lira zgjedhore (grafiku 2). Përgatitja e pavarur është mënyra më jo tipike e përgatitjes së lëndëve të lira zgjedhore, veçanërisht për mësimdhënësit me mësim në gjuhën maqedonase (11,6%).




Grafiku 2: Përgjigjet e pyetjes nga mësime dhënësit realizues: Kush e përgatiti programin mësimor për lëndën tuaj zgjedhore?

Siç shihet nga tabela 1, mësime dhënësit ndihen më rehat kur në mënyrë të pavarur krijojnë program mësimor për lëndët e kategorisë së parë. Këto lëndë, së bashku me lëndët sportive dhe rekreative, janë kategoritë e lëndëve në të cilat më së shpeshti raportohet bashkëpunimi me mësime dhënësit tjerë të shkollës (46.3% dhe 47.2%). Edhe pse përqindjet janë relativisht të shpërndara në mënyrë të barabartë në të katër kategoritë e lëndëve, mësime dhënësit më së shumti përdorën programet e krijuara nga BZHA-ja gjatë realizimit të lëndëve zgjedhore për mbështetjen e zhvillimit personal dhe social të nxënësve (27.9%). Një konstatim interesant është se në të gjitha kategoritë, përveç të parës, mbizotëron numri i mësime dhënësit që kanë deklaruar se kanë përgatitur programin mësimor në bashkëpunim me mësues nga një shkollë tjetër.

Tabela 1: Përgjigjet e pyetjes nga mësime dhënësit realizues: Kush e përgatiti programin mësimor për lëndën tuaj zgjedhore? për kategoritë e ndryshme të lëndëve zgjedhore


	Për zgjerimin/ thellimin e njohuritë nga lëndët e detyrueshme mësimore	Për mbështetjetë interesave të nxënësve që nuk janë pjesë e lëndëve të detyrueshme	Për mbështetjetë të zhvillimit personal dhe social të nxënësve	Me karakter sportiv- rekreativ
Në mënyrë të pavarur	16,4	10,9	12,7	12,6
Në bashkëpunim me tjerë mësues të shkollës	46,3	40,8	40,1	47,2
Në bashkëpunim me një mësime dhënësit/mësime dhënësit nga një shkollë tjetër	14,6	21,8	19,3	13,5
Byroja e Zhvillimit të Arsimit	22,7	26,4	27,9	26,7

Numri më i madh i mësimitdhënësve (63,9%) raportojnë se lëndët zgjedhore i kanë organizuar në bazë të interesit që kanë treguar nxënësit, veçanërisht është i theksuar kur mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase (74,5%). Zgjedhjet tjera të alternativave të ofruara është shumë e ulët (Grafiku 3). Vlen të theksohet se rreth 40% e mësimitdhënësve që japin mësim në gjuhën turke pohojnë se zgjedhja është bërë për arsye të parëndësishme, siç është “kërkesa e drejtorit” dhe “plotësimi i fondit të orëve për mësimitdhënësit”.



Grafiku 3: Përgjigjet e pyetjes nga mësimitdhënësit realizues: Si është përcaktuar realizimi i lëndës tuaj zgjedhore?

Na gëzon rezultati se shumica e mësimitdhënësve realizues (71.7%) kanë përshtypjen se lënda e lirë zgjedhore që e realizojnë trajtohen po me aq rëndësi sa edhe lëndët e detyrueshme (grafiku 4). Vetëm 2.6% e mësimitdhënësve të anketuar raportuan se lënda trajtohet pothuajse krejtësisht e parëndësishme. Krahasimi sipas gjuhëve mësimore tregon se statusi i barabartë i lëndëve zgjedhore me lëndët e tjera si perceptim dominon te mësimitdhënësit që japin mësim në gjuhën maqedonase dhe disi më pak te mësimitdhënësit që japin mësim në gjuhën shqipe. Sipas të dhënave, në mënyrë të dukshme janë dallimet e marra nga mësimitdhënësit që japin mësim në turqisht, të cilat janë të ndara mes atyre që besojnë se lëndët e tyre zgjedhore janë trajtuar si njësoj të rëndësishme dhe atyre që besojnë se janë trajtuar si më pak të rëndësishme.




Grafiku 4: Përgjigjet e pyetjes nga mësime të realizues: Si është trajtimi i lëndës suaj zgjedhore në shkollë?

Nëse analizojmë rëndësinë që u përshkruhet lëndëve të lira zgjedhore nga kategoritë e ndryshme (tabela 2), mund të vërehet se vetëm ato të karakterit sportive-rekreative mund të thuhet se në sytë e realizueseve të tyre trajtohen si më pak të rëndësishme se kategoritë e tjera të lëndëve të lira zgjedhore.

Tabela 2: Përgjigjet e pyetjes nga mësime të realizues: Si është trajtimi i lëndës suaj zgjedhore në shkollë? për kategoritë e ndryshme të lëndëve zgjedhore

	Për zgjerimin/ thelimin e njohuritë nga lëndët e detyrueshme mësimore	Për mbështetjet interesave të nxënësve që nuk janë pjesë e lëndëve të detyrueshme	Për mbështetje të zhvillimit personal dhe social të nxënësve	Me karakter sportiv- rekreativ
Po aq e rëndësishme sa shumica e lëndëve të detyrueshme	72,5	75,6	73,4	69,2
Më pak e rëndësishme se shumica e lëndëve të detyrueshme	25,6	21,8	24,4	27,3
Pothuajse krejtësisht e parëndësishme	2,0	2,6	2,1	3,5


Në kuadër të këtyre të dhëna është edhe vlerësimi i mësimeve për atë se si është raporti i nxënësve gjatë zbatimit ndaj këtyre lëndëve (grafiku 5). Në shkallën nga 1 deri në 5 (1 = nuk janë fare / ishin të motivuar dhe aktivë deri në 5 = jashtëzakonisht ishin/janë të motivuar dhe aktiv), motivimi i nxënësve është vlerësuar si më i larti nga mësime të realizues që japin mësim në gjuhën maqedonase. (M = 4,38; SD = 0,8). Nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe janë vlerësuar disi më pak të motivuar (M = 4,05; SD = 1,04), dhe më së paku nxënësit që mësojnë në gjuhën turke (M = 3,92; SD = 1,09).



Grafiku 5: Përgjigjet e pyetjes nga mësuesit realizues: Cila ishte/si është sjellja e shumicës së nxënësve gjatë orëve të lëndës suaj zgjedhore? (mjediset aritmetike)

Kur bëhet krahasimi sipas kategorive të lëndëve të lira zgjedhore, mësuesit vlerësojnë motivimin dhe aktivitetin e nxënësve si më poshtë: nxënësit janë më shumë të motivuar dhe aktivë në lëndët zgjedhore që punohet me përmbajtjet se sa ato lëndë që kanë lidhshmëri me mësimin e detyrueshëm ($M = 4.36$; $SD = 0,96$), mandej vijojnë lëndët nga karakteri sportive-rekreative ($M = 4,32$; $SD = 0,92$) dhe për mbështetje të zhvillimit personal dhe social të nxënësve ($M = 4,29$; $SD = 0,95$), si më pak stimuluese për aktivitetin e nxënësve u vlerësuan lëndët zgjedhore që shërbejnë për të thelluar ose zgjeruar njohuritë e lëndëve të detyrueshme ($M = 4,18$; $SD = 0,78$).

Mësuesit realizues patën mundësinë të zgjidhnin maksimumi tre nga pesëmbëdhjetë përfitimet e mundshme të ofruara të cilat do t'i veçonin për të përshkruar efektet e realizimit të lëndëve të lira zgjedhore. Analiza e të dhënave (grafiku 6) tregoi se në sytë e tyre, përfitimi dominues është se nxënësit fitojnë njohuri dhe shkathtësi të reja (44.2%). Megjithatë, në këtë kategori përgjigjesh diferenca ndërmjet përqindjes së mësuesve që realizojnë mësimin në gjuhën maqedonase (62,3%) dhe ata që japin mësim në gjuhën shqipe (22,7%). I rëndësishëm është proporcioni i përgjigjeve për përfitimet që i takon edhe kategorisë së shoqërimit mes nxënësve, e ndjekur nga: bashkëpunimi ndërmjet nxënësve nga klasa të ndryshme (20.4%) dhe motivimi i nxënësve për të mësuar (19.4%). Mësuesit që realizojnë mësimin në gjuhën shqipe vjen në shprehje përfitimi që shpeshherë e bëjnë zgjedhjen e bashkëpunimit ndërmjet nxënësve (25.3%), krahasuar me kolegët e tyre që japin mësim në gjuhën maqedonase (16.0%). Vihet re një ndryshim tjetër i rëndësishëm kur krahasojmë përgjigjet e mësuesve që japin mësim në gjuhën turke me dy gjuhët e tjera mësimore. Përshtypja e përgjithshme është se për këta mësues funksioni i lëndëve zgjedhore është më i përqendruar në relaksim, shoqërim, bashkëpunimin dhe përmirësimin e atmosferës sesa në përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të reja ose në zotërimin e materialit nga lëndët e tjera. Gjithashtu shihet se te mësuesit që japin mësim në gjuhën turke, përfitimet janë shumë më të shpërndara nëpër kategori sesa te mësuesit që japin mësim në gjuhën maqedonase dhe shqipe, të cilët përgjigjet i përqendrojnë në disa kategori kryesore.



Grafiku 6: Përgjigjet e pyetjes nga mësuesit realizues: Cilat janë përfitimet nga realizimi i lëndës zgjedhore? (deri në tre përgjigje)


Ndërthurja e përfitimeve të perceptuara me kategoritë e ndryshme të lëndëve zgjedhore (tabela 3) tregon se më shumë se 20% e mësimitdhënësve realizues na bëjnë me dije se lënda e tyre zgjedhore, pavarësisht kategorisë së cilës i përket, çon në përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të reja, si dhe në shoqërimin mes nxënësve, megjithëse përfitimi i parë është dominues në lëndët për të mbështetur interesat e nxënësve që nuk janë pjesë e lëndëve të detyrueshme dhe i dyti në lëndët me karakter sportiv-rekreativ. Është karakteristike se vetëm lëndët zgjedhore të karakterit sportiv-rekreativ mundësojnë përvetësimin e shprehive për jetë të shëndetshme dhe relaksim nga stresi. Bashkëpunimi mes nxënësve të klasave të ndryshme dhe motivimi i nxënësve për të mësuar konsiderohen si përfitime nga lëndët zgjedhore që plotësojnë lëndët e detyrueshme ose kanë të bëjnë me interesat e tjera të nxënësve, ndërsa nxitja e talentit sigurohet përmes lëndëve zgjedhore sportive-rekreative dhe lëndët zgjedhore që mbështesin interesat shtesë të nxënësve.

Tabela 3: Përgjigjet e pyetjes nga mësimitdhënësit realizues: Cilat janë përfitimet e realizimit të lëndës suaj zgjedhore? për kategoritë e ndryshme të lëndëve zgjedhore

	Për zgjerimin/ thelimin e njohuritë nga lëndët e detyrueshme mësimore	Për mbështetje të interesave të nxënësve që nuk janë pjesë e lëndëve të detyrueshme	Për mbështetje zhvillimit personal dhe social të nxënësve	Me karakter sportiv- rekreativ
Shoqërimi mes nxënësve	35,0	36,5	36,4	45,2
Bashkëpunimi ndërmjet nxënësve nga klasa të ndryshme	22,9	21,3		
Përvetësimi i shprehive për jetë të shëndetshme				21,4
Relaksimi nga stresi				23,5
Motivimi i nxënësve për të mësuar	20,4	21,3		
Përvetësimi i njohurive dhe shkathtësive të reja	41,5	63,5	49,5	39,9
Nxitja e talentit		23,0		22,3

Në tabelë janë paraqitur vetëm përqindjet e përgjigjeve për të cilët janë përcaktuar më shumë se 20% e numrit të përgjithshëm të mësimitdhënësve realizues të lëndës zgjedhore nga kategoria e dhënë.

Ndër alternativat e ofruara, si pengesa të supozuara për zbatimin e mësimdhënies në lëndët e lira zgjedhore, nga të cilat mësimdhënësit mund të zgjidhnin maksimumi dy, mbizotërojnë përgjigjet në kategoritë që lidhen me mungesën e burimeve materiale. Mungesa e pajisjeve dhe burimeve për realizim, nga 41,3% të zgjedhur mësimdhënës, së bashku me kushtet e papërshtatshme hapësinore për zbatimin e lëndës zgjedhore, të treguara me 37,7%, qartë “çojnë” në pjesën tjetër të sfidave. Nga shpërndarja e përgjigjeve të ndara sipas gjuhëve mësimore (grafiku 7), një e dhënë del si e pazakontë – deri në 24% e përgjigjeve të mësimdhënësve që japin mësim në gjuhën turke i referohen mungesës së interesit të nxënësve për lëndët zgjedhore. Mungesa e pajisjeve dhe resurseve më shpesh shihet si pengesë nga mësimdhënësit që japin mësim në gjuhën maqedonase sesa kolegët e tyre nga gjuhët e tjera mësimore, të cilët, nga ana tjetër, në krahasim me ta, bëjnë dukshëm më shumë zgjedhje në kategoritë e kushteve joadekuate hapësinore. Jemi të kënaqur me të dhënat e marra se relativisht numër i vogël i zgjedhjeve nga të tre grupet është bërë në kategoritë e qëndrimit jo serioz të nxënësve apo mungesës së interesimit të nxënësve.




Grafiku 7: Përgjigjet e pyetjes nga mësimdhënësit realizues: Çka nga lartë e përmendura ishte/është pengesë më e madhe për ju gjatë organizimit dhe realizimit të lëndës zgjedhore? (deri në 2 përgjigje)

Tabela 4: Përgjigjet e pyetjes nga mësime të realizues: Nga e theksuara deri më tani, cila paraqitet/është pengesa më e madhe për ju gjatë organizimit dhe realizimit të lëndës zgjedhore? për kategoritë e ndryshme të lëndëve zgjedhore

	Për zgjerimin / thellimin e njohuritë nga lëndët e detyrueshme mësimore	Për mbështetjetë interesave të nxënësve që nuk janë pjesë e lëndëve të detyrueshme	Për mbështetjetë zhvillimit personal dhe social të nxënësve	Me karakter sportiv-rekreativ
Përgatitja e program mësimor sipas modelit të dhënë	26,7	19,8	20,3	18,5
Kushtet e papërshtatshme hapësinore për realizim	37,3	39,4	36,0	46,9
Përfshirja e lëndës në orarin e orëve mësimore	14,0	11,8	10,2	12,3
Interesimi i pamjaftueshëm i nxënësve	5,7	3,7	6,4	2,3
Qëndrimi joserioz i nxënësve ndaj lëndës	5,1	2,9	5,5	2,6
Mungesa e pajisjeve dhe burimeve për realizim	39,7	50,6	46,3	42,5
Asgjë nga e theksuara më lartë	13,4	14,9	17,3	14,4


Analiza e barrierave gjatë realizimit të kategorive të ndryshme të lëndëve zgjedhore na tregon se më së shumti probleme ka me kushtet hapësinore për realizimin e lëndëve me karakter sportiv-rekreativ (46,9% nga zgjedhjet), edhe pse nga kjo pengesë nuk janë kursyer as kategoritë tjera të, ku zgjedhjet arrijnë nga 36 deri në 39,4%. Përgatitja e programit mësimor duket më e ndërlikuar për kategorinë e lëndëve përmes të cilave zgjerohen dhe thellohen njohuritë nga lëndët e detyrueshme, ndërsa mungesa e materialeve dhe burimeve më së shumti ndikon te lëndët që kanë në fokus përvetësimin e njohurive të reja (tabela 4).

Në bazë të përvojave, mësime të realizues, në përqindjen më të madhe, gati gjysma (43.4%), nuk do të ndryshonin asgjë gjatë realizimit të radhës të së njëjtës lëndë. Në të njëjtën kohë, pak më shumë se 20% besojnë se mund të bëjnë ndryshime në mënyrën se si u prezantohet lënda nxënësve përpara se ta zgjedhin atë, si dhe në qasjen didaktike të realizimit të saj (grafiku 8). Në 4.4% e mësime të realizuesve të anketuar parqet përqindjen e parëndësishme e deklarimit të tyre se nuk do ta përsërisnin realizimin lëndës konkrete zgjedhore. Rezultatet sugjerojnë se më të kënaqur me realizimin e lëndës zgjedhore janë mësime të realizues që mbajnë mësim në gjuhën maqedonase, sepse te ato dominon përqindja e prezantuar e përgjigjeve në kategorinë se nuk do të ndryshonin asgjë. Ka dallime të mëdha për sa i përket gjuhës mësimore dhe si e kanë paraqitur mësime të realizues në mënyrë adekuate lëndën para nxënësve.



Grafiku 8: Përgjigjet e pyetjes nga mësimehënësit realizues: Çfarë do të ndryshonit/a keni ndryshuar diçka gjatë përsëritjes së realizimit të së njëjtës lëndë zgjedhore?


Mësimehënësit realizues patën mundësinë të zgjidhnin se cili lloj i mbështetjes nga BZHA do të ishte më i nevojshëm për ta, pra më e dobishme kur bëhet fjalë për lëndët e lira zgjedhore. Lloji më i shpeshtë i zgjedhur i ndihmës së nevojshme është trajnimi i mësimehënësve për realizimin e lëndëve zgjedhore në mbështetje të interesave të nxënësve, pasuar nga sigurimi i programeve të gatshme mësimore për numër më të madh të lëndëve zgjedhore. Grafiku 9 gjithashtu tregon se numër shumë i vogël i zgjedhjeve morën opsionin që nuk kërkohej mbështetjen e veçantë nga BZHA-ja. Dallimi më i dukshëm është nëse i krahasojmë përgjigjet sipas gjuhës mësimore, disproporcioni është i madh te nevoja e shprehur që BZHA-ja të ofrojë programe të gatshme për numër më të madh lëndëve zgjedhore, me çka zgjidhja më e madhe bëhet nga ana mësimehënësve që japin mësim në gjuhën maqedonase (45.1%), krahasuar me kolegët që japin mësim në gjuhën shqipe (27.7%) dhe në gjuhën turke (18.9%).



Grafiku 9: Përgjigjet e pyetjes nga mësime dhënësit realizues: Çfarë mbështetje nga Byroja do të dëshironi të merrni? (deri në 2 përgjigje)


2. Rezultatet për MËSIMDHËNËSIT E MUNDSHËM REALIZUES të lëndëve të lira zgjedhore

Sipas përgjigjeve të mësimdhënësve që morën pjesë në hulumtim nga pozicioni i realizuesve të mundshëm të lëndëve të lira zgjedhore (N = 2686), në pyetjen nëse do të dëshironit në të ardhmen të realizoni mësimet e këtij lloji, mes tyre mbizotëron qëndrimi pozitiv ndaj kësaj mundësie (grafiku 10). Ndonëse dallimet nuk janë shumë të mëdha, më të interesuarit janë mësimdhënësit që japin mësim në gjuhën shqipe. Nëse, sipas kohëzgjatjes së përvojës të punës, mësimdhënësit nga kjo mostër ndahen në dy kategori - nën dhe mbi mesataren për gjithë grupin, rezultojnë se ata me përvojë më shkurtë pune, më shpesh deklarojnë se janë më të interesuar (61.2%). se kolegët e tyre me përvojë më të gjatë pune (38.8 %).



Grafiku 10: Përgjigjet e pyetjes nga mësimdhënësit realizues: A do të dëshironit dhe ju të realizoni lëndë të lirë zgjedhore?


